



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsimit

Odeljenje za Obrazovanje

Drejtoria Komunale e Arsimit

-IV- Nr. i prot. 100 Më 18.01.2015
Br. prot. Odeljenje za Obrazovanje
RAHOVEC - ORAHOVAC Department of Education



Në bazë të nenit 66.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr.03/L-40, neni 6 të Statutit të Komunës, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.08/2014 të datës 25.02.2014, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

KONKURS

I- Për zgjedhjen e drejtorëve të SHFMU dhe SHML të komunës së Rahovecit

- 1) Një drejtor për SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Drenoc
- 2) Një drejtor për SHFMU “Heronjtë e Kosovës” në Hoçë e Vogël-Brestoc
- 3) Një drejtor për SHFMU “Tre Dëshmorët” në Vrajak-Bratotin
- 4) Një drejtor për SHFMU “Skënder Kastrati” në Radoste
- 5) Një drejtor në SHFMU “7 Shtatori” në Rahovec
- 6) Një drejtor në SHFMU “Bajram Curri” në Krushë të Madhe
- 7) Një drejtor në SHFMU “Sylejman Vokshi” në Polluzhë
- 8) Një drejtor në SHFMU “Mustaf Ibishi” në Kramovik
- 9) Një drejtor në SHML “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec
- 10) Një drejtor në SHML “12 Maji” në Ratkoc

Kushtet për konkurim:

1. Të gjithë kandidatët e interesuar për konkurim në vendet e punës për drejtor shkolle duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
 - 1.2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënëseve dhe Normativit mbi punësimin e kuadrit të mësimdhënëseve dhe rregullativës tjetër ligjore.
 - 1.3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit.
2. Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim e menaxhim.
3. Të kenë së paku 3 vite përvojë pune në arsim ose në institucione arsimore.
4. Kandidatët konkurent duhet të posedojnë këto dokumente:
 - 4.1. Ekstraktin e lindjes
 - 4.2. Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës
 - 4.3. Dëshminë për përvojën e punës

- 4.4. Portfolijen profesionale (shihni shtojcen" G" të U A 08/2014)
- 4.5. Letër referencë nga një institucion publik kredibil (si MASHT-i, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë)
- 4.6. Letër referencë, e cila duhet të ketë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake.
- 4.7. Planin zhvillimor të institucionit edukativo arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkuruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12)
- 4.8. Cetifikatën shëndetsore të lëshuar nga një institucion publik shëndetsor.
- 4.9. Dëshminë që dëshmon që kandidati/ia nuk është nën hetime.

Detyrat e punës:

Detyrat e punës së drejtorit të shkollës janë të përcaktuara në rregulloret për organizimin e punës dhe të mësimit në shkollë.

Kohëzgjatja: Marrëdhënia e punës lidhet përmes kontratës, në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe zgjat 4 (katër) vite, duke e përfshirë edhe periudhën tremujore provuese.

Aplikacionet për konkurim merren në DKA dhe dokumentet dorëzohen po aty.

Afati i konkurimit është 15 ditë nga dita e shpalljes të konkursit.

RAHOVEC
18.05.2018

